



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 134/9 prot.

Tiranë, më 11.05.2021

VENDIM

Nr.50, datë 11.05.2021

PËR

**PEZULLIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 30, DATË 19.03.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 30, datë 19.03.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1 datë 09.11.2020, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, për dhënie të masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunësit *****”, me detyrë “ Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 881 prot., datë 12.11.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin për disa parregullsi të kryera ose të lejuara nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në lidhje me zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezultojnë të vërtetuara që: Kërkuesi ***** është prej shumë vjetësh, nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin “Drejtor, në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” në Këshillin e Qarkut Dibër.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Këshillit të Qarkut Dibër të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 30, datë 19.03.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1 datë 09.11.2020, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, për dhënie të masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunësit ***** me detyrë “ Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes ”.*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Këshillit të Qarkut Dibër ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 30, datë 19.03.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Këshillin e Qarkut Dibër, për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr. 30, datë 19.03.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Dibër, që të drejtojë procesin administrativ nëpërmjet të cilit, Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, në cilësinë e eprorit direkt, në zbatim të neneve 113 dhe 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të shfuqizojë vendimin nr. 1, datë 09.11.2020, *“Për akordimin e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin ***** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Këshillin e Qarkut Dibër”*, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe nenit 109, pikat “d” dhe “dh”, të Kodit të Procedurave Administrative si dhe të marrë masa për fshirjen e masës disiplinore të dhënë në ngarkim të nëpunësit ***** , nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

Konstatohet se, Këshilli i Qarkut Dibër me shkresën nr. 272/14 prot., datë 07.04.2021, ka njoftuar Komisionerin se nga ana e institucionit është depozituar kërkesëpadia pranë Gjykatës kompetente kundrejt vendimit paralajmërues.

Përsa kohë vlefshmëria e Vendimit të Komisionerit është duke u shqyrtuar nga Gjykata, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, propozojmë që të miratohet pezullimi i procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, për këtë rast deri sa Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Pezullimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 30, datë 19.03.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1 datë 09.11.2020, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër, për dhënie të masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunësit *****, me detyrë “ Drejtor në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”*.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Këshillit të Qarkut Dibër dhe nëpunësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA